



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.17 prot.

Himarë, më 22.12. 2025

ZBARDHJE E PROTOKOLLIT NGA ORGJINALI I MBLEDHJES TË RADHES SË KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË.

Sot më datë 22.12.2025 zhvillohet mbledhja e radhës kërkuar nga Kryetari i Këshillit Bashkiak. Hapet mbledhja në orën 10:00.

Të ftuar, kryetari i Bashkisë, nënkryetarët e Bashkisë, drejtoritë, administratorët e njësive, kryetarët e fshatrave.

Marrin pjesë këshilltarët :

Dhimitër Kapaj, Lenica Kocani, Elisabeta Lamaj, Aleks Llazari , Mirka Gjiçali, Timoleo Gërdhuqi, Milto Nika, Thëllëza Kokaveshi, Miltiadh Prifti, Maks Vlashi, Qirjako Mërkuri, Artan Bala, Theodhori Foto, Loreta Isufi, Nikolin Laska, Silva Burbo, Nertila Husi, Ervis Caushaj.

Plotësohet kuorumi me 18 anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Hap mbledhjen Kryetari i Këshillit dhe dakordëson me rendin e ditës pasi lexon dhe lighshmëritë e vendimeve të kthyera nga Prefektura për mbledhjet e muajve Shtator dhe Tetor 2025.

Kryetari i Këshillit vendos që të mblidhet kryesia për një projektvendim që ka ardhur në Këshill në momentin e fundit për dhënien e ndihmës financiare për katër familje në zonën e Horë Vranishtit. Kryesia vendos që ky projektvendim të hyjë në rendin e ditës.

Rifillon mbledhja sipas rendit të ditës.

Pika e parë: PBA

Pyetje, sqarime, sugjerime dhe miratime për PBA-në. Sqaron Dr. e Financës për pyetjet që bëhen. Sqaron dhe Kryetari i Bashkisë për PBA-në.

Pyetje nga Këshilltarja Kokaveshi: Nëse ne si Këshill Bashkiak do të duhet të bëjmë ndryshime mbi PBA, si do të veprohet?

Sqaron Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Financës.

Këshilltarja Burbo pyet Kryetarin e Bashkisë se pse ka ardhur në këshill PBA kur duhet të bëjnë ndryshime në buxhet?

Sqarohet nga Drejtoria Juridike përsa i përket pyetjes.

Pyetje nga Këshilltari Gërdhuqi: Pse tek PBA në zonën e Borshit nuk ka asnjë investim?

Përgjigjet Kryetari i Bashkisë.

Kryetari i Këshillit propozon që shëtitorja e Borshit të kalojë në PBA për vitin që vjen.

Propozon Këshilltari Caushaj që të futen në buxhet edhe fasadat e pallateve në fshatin Piqeras.

Pyetje nga Këshilltari Prifti: Kur të priset stadiumi dhe të ndryshojë vendndodhje, sa kohë do të rrijë qyteti pa stadium dhe pallat sporti?

Përgjigjet Kryetari i Bashkisë.

Propozon Këshilltarja Burbo që të mos preket stadiumi dhe të mos ndryshojë vendndodhje.

Kalojnë për votim këto propozime.

Propozimi i këshilltares Burbo nuk kalon, pasi u votua me 11 vota kundër.

Propozimi i Kryetarit të Këshillit për shëtitoren e Borshit kalon me 16 vota pro.

Kalon për votim PBA-ja me ndryshimet e propozuara 11 PRO, 5 KUNDËR, 2 ABSTENIM

Pika e dytë / Pika e tretë: Numri i përgjithshëm i punonjësve.

Po bëhen pyetje për këtë projektvendim nga Këshilltarët. Përgjigjen drejtoritë përkatëse dhe Kryetari i Bashkisë.

Kalon për votim ky projektvendim (Numri i përgjithshëm i punonjësve).

11 PRO, 8 KUNDËR, 0 ABSTENIM

Kalon për votim dhe pika e tretë (Punonjësit me kontratë të përkohëshme).

11 PRO, 8 KUNDËR, 0 ABSTENIM

Këshilltarët kërkojnë 15 minuta pushim. Ora 13:00

Rifillon mbledhja. Ora 13:30.

Pika e katërt: Buxheti

Pyetje nga Këshilltarja Dhimojani: Sa është buxheti për vitin 2026?

Përgjigjet Drejtoria e Financës dhe Kryetari i Bashkisë: 78 milion euro.

Po e njëjta Këshilltare pyet: Sa është buxheti i NSHP-së për vitin 2026?

Përgjigjet Drejtoria e Financës: 7% e Buxhetit të Bashkisë.

Këshilltari Nika plotëson sqarime për buxhetin, shton dhe një kërkesë që buxheti të ketë investime të shtuara dhe në Bujqësi dhe Blegtori.

Propozim për buxhetin nga Këshilltari Prifti: Rrugët bujqësore të bëhen me emergjencë dhe të tenderohen, të mos bëhen nga NSHP. Bie propozimi, nuk merr votat e mjaftueshme.

Kalon për votim projektvendimi për buxhetin. 13 PRO, 4 KUNDËR, 0 ABSTENIM

Pika e pestë: Klubi i Sportit Himara

Kalon për votim propozimi për klubin e Sportit me ndryshimet dhe emrat përkatës.

Emrat: Gjergji Iliadhi, Pano Dhimaleksi, Llambro Ruci, Robert Bollano, Niqifor Konomi, Ilir Vongli, Kristo Rondo

Votohet: 17 PRO, 0 KUNDËR, 0 ABSTENIM

Pika e gjashtë / Pika e shtatë: Ndhima ekonomike 6% dhe Ndhima financiare për familjet e zonës së Horë Vranishtit.

Votohet: 17 PRO, 0 KUNDËR, 0 ABSTENIM

Mbyllet mbledhja, ora 15:30

Sekretari : Zaho Dedi